

Mr. Jahja Drançolli

VËSHTRIM MBI KOSOVËN GJATË FEUDALIZMIT TË ZHVILLUAR

Që nga periudha antike dhe në periudhat e mëpastajsme historike, territori i sotëm i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës është shtrirë në një udhëkryq të dyndjeve dhe ndikimeve që vinin nga vise të ndryshme. Gjatë tri fazave të periudhës mesjetare ajo nuk paraqitet si një tërësi territoriale dhe administrative. Pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë; në Perëndimore dhe Lindore, territori i Kosovës në tërësi hyri në kuadrin e Perandorisë Bizantine.¹ Ndërkaq, gjatë feudalizmit të zhvilluar, Kosova, si një trevë me shumë begati natyrore dhe pozitive gjeografike të jashtëzakonshme, bëhet vatër e ngjarjeve të mëdha historike me rëndësi ballkanike dhe, herë pas here, edhe më gjerë.

1. Rrethanat politike

Fillet e aktualizimit të Kosovës në skenën ndërkombëtare gjatë feudalizmit të zhvilluar datojnë nga gjysmë e dytë e shekullit XI, pikërisht në vitin 1072 a 1073. Atëbotë Prizreni (Prisdiana) u bë qendër e kryengritjes drejtuar kundër pushtetit të perandorit bizantin (Mihajli VII Duka) në këtë anë dhe më gjerë. Në krye të kryengritjes qendronin Konstantin Bodeni dhe Gjergj Vojteku.²

Sipas ballkanologut Konstantin Jireček, kufiri ndërmjet principatës së Rashës dhe Perandorisë Bizantine kalonte nëpër pjesën veriore të Kosovës së sotme,³ ndërsa Kështjella e Zveçanit, që zihet nga për herë të parë në veprën „Aleksiada” të kronistës së njohur bizantine Ana Komnena,⁴ konsiderohet kështjellë e rëndë-

¹ G. Ostrogorski, *Istoriya Vizantije*, Beograd, 1969, f. 70—87; *Istoriya naroda Jugoslavije I* Beograd, 1953, f. 30—57, 229—256; K. Jireček, *Istoriya Srba I*, Beograd 1952, f. 17—33, 63—89.

² *Vizantijski izvori za istoriju naroda Jugoslavije III*, Beograd 1969, f. 70—87; K. Jireček, *Istoriya Srba, I*, f. 135; *Istoriya srpskog naroda I*, Beograd 1981, f. 190.

³ K. Jireček, *Istoriya Srba I*, f. 137—139.

⁴ Prof. dr. Desanka Kovačević — Kojić në një punim të vet gabon kur thotë se Zveçani zihet nga për herë të parë sipas burimeve his-

sishme kufitare në anën serbe, ndërsa Lipjani u gjend në kuadrin e administratës bizantine.⁵ Zveçani, pasi u pushtua prej princave të Pashës, u shndërrua në kështjellë mbrojtëse për të hyrë në bërthamën e shtetit serb. Njëkohësisht prej kësaj fortifikate organizoheshin sulme të befasishme në vende të tjera të Kosovës, të cilat deri në gjysmën e dytë të shekullit XII ishin nën sundimin bizantin. Gjatë shekujve XI dhe XII trojet e Kosovës ishin arenë konfliktesh ndërmjet ushtrisë serbe dhe asaj bizantine.⁶ Qysh nga fundi i shekullit XI, zhupani Vukan e sulmoi edhe e dogji Lipjanin. Në drejtim të këtij vendi ishte nisur vetë perandori bizantin me qëllime që ta rikthente Lipjanin, si dhe troje të tjera të pushtuara nga zhupani serb. Pasi u informua për ekspeditën e perandorit, Vukani iku në Zveçan, „qytezë në trevën malore të Zigonit, në kufi ndërmjet tokave bizantine dhe të Dalmacisë”.⁷ Luftimet rreth Zveçanit zgjatën edhe në gjysmën e parë të shekullit XII, mirëpo fati i kësaj kështjelle në këtë kohë mbetet krejt i panjohur. Luftimet kufitare ndërmjet princave serbë dhe perandorëve bizantinë një kohë të gjatë nuk dhanë ndonjë rezultat të dukshëm. Disa sundonin perandorët e dinastisë së Komnenëve, Perandoria Bizantine qëndronte mjaft fort në Gadishullin Ballkanik. Ardhja e Stefan Nemanjës në krye të pushtetit serb dhe kriza e rëndë që e rrëmbeu bizantin, ndikuan dukshëm për ndryshimin e hartës politike të Ballkanit. Që në vitet e para të sundimit Nemanja arriti ta mundte vëllanë, Tihomirin në fshatin Pantinë afër Zveçanit. Në betejën e Pantinës në anën e Tihomirit ishin edhe bizantinët, së bashku me mercenarët e vet frankë dhe turq.⁸ Me fitoren te Pantina, Stefan Nemanja ende s’kishte fituar epërsi në Kosovën Veriore, porse u forcua në pushtet. Megjithatë, rrafshi i Kosovës gjatë sundimit të tij ishte përfshirë në përbërjen e shtetit serb.⁹ Në periudhën e viteve 1180—1190 Stefan Nemanja u zgjerua dukshëm në Kosovë, duke pushtuar rrafshin e Kosovës (Llapin, Lipjanin, Sitnicën) dhe pjesën e Metohisë nemanjide (Patkovën, Hvosnën, Po-

torike në vitin 1091 — shiko punimin e autores në fjalë botuar në monografinë „Kosova dikur e sot” Prishtinë 1973, f. 109; nëse konsultohen burime bizantine, atëherë mund të vërehet pa vështirësi se Zveçani për herë të parë me këtë emër, por të natyrës bizantine, është zënë nga vitin 1092 a 1093 — *Vizantijski izvori za istoriju naroda Jugoslavije III*, f. 385—388.

⁵ *Vizantijski izvori za istoriju naroda Jugoslavije III*, f. 386—388; S. Novaković, *Srpske oblasti X i XII veka*, Glasnik SUD, XLVIII, Beograd 1880, f. 111—114.

⁶ K. Jireček, *Istorija Srba I*, f. 137—138; *Vizantijski izvori za istoriju naroda Jugoslavije III*, 385—388; R. Mihalçiq, *Mitrovica dhe rrethina gjatë periudhës mesjetare*, punim i botuar në monografinë *Mitrovica dhe rrethina*, Mitrovicë 1979, f. 51.

⁷ *Vizantijski izvori za istoriju nar. Jugoslavije III*, f. 385—388; R. Mihalçiq, *Mitrovica dhe rrethina në periudhën mesjetare*, f. 51.

⁸ K. Jireček, *Istorija Srba I*, f. 147—160; I. Kukuljević — Sakcinski, *Prvovjenčani vladaoci Bugara, Hrvata i Srba, i njihove krune*, RAD, JAZU, Zagreb 1881/LIX, f. 119—122.

⁹ K. Jireček, *Istorija Srba I*, f. 150; *Istorija Naroda Jugoslavije I*, f. 328 — 329; I. Kukuljević — Sakcinski, *Prvovjenčani vladaoci Bugara, Hrvata i Srba, i njihove krune*, RAD, JAZU, f. 117—120.

drimjen, Kostercin, Dërshkovinën).¹⁰ Trojet e pushtuara në fjalë, meqë në fund të shekullit XII Bizantini e kishte goditur një krizë e rënd dhe në atë gjendje ishte e pamundur të luftonte në disa fronte, perandori bizantin u detyrua t'i pranonte edhe zyrtarisht si vise serbe. Tani zhupani serb, pas përpjekjeve shumëvjeçare, u bë i pavarur dhe arriti të zgjerohet edhe në pjesën dërmuese të Kosovës.¹¹

Rënia e Perandorisë Bizantine pas Kryqëzatës së Katërt (1202—1204) bëri që të ndryshonte tërësisht harta politike e Gadishullit Ballkanik. Atëbotë biri i Stefan Nemanjës, Stefan Përvoençani (1196—1228), përfundimisht futi në dorë të gjitha trojet e Kosovës dhe kësioj fati i Kosovës tani e deri në vitin 1371 ishte ngushtësisht i lidhur me shtetin nemanjid.¹² Pas përtëritjes së Perandorisë Bizantine në vitin 1261,¹³ perandori bizantin, Mihajli VIII Paleologu (1259—1282), u përpoq të ripushtonte pjesët e mbretërisë nemanjide, të cilat, së bashku me trojet e shtetit bullgar, si-

¹⁰ *Istoriya srpskog naroda I*, f. 258; *Istoriya naroda Jugoslavije*, f. 330; K. Jireček, *Istoriya Srba I*, f. 157; I Kukuljević — Sakcinski, *Prvovjenčani vladaoci Bugare, Hrvata i Srba, i njihove krune*, f. 127—128; M. Dinić, *The Balkans 1018—1499, Cambridge Medieval History IV*, Cambridge 1966, f. 520—522; M. Nikolić, *Srednjovekovna župa Patkovo, Istarski Casopis*, Beograd 1971/XVIII, f. 207—214; R. Novaković, *O nekim pitanjima granice Srbije krajem XII i početkom XIII veka*, Zbornik FF, Beograd 1967/IX-1, f. 121—161; Në këtë rast është mjaft interesant të shqyrtohet emërtimi gjeografik i Metohisë. Termi Metohi (greqisht metohion) gjatë kohës së sundimit nemanjid ka pasur kuptimin e „pronave kishtarë”. Për atë kohë ka qenë shumë e natyrshme që edhe ultësira në fjalë të emërtohet kësioj, meqë ajo është gjendur midis pronave të mëdha kishtarë.

¹¹ Në historiografinë e sotme jugosllave dominon mendimi se e tërë Kosova që në kohën e sundimit të Stefan Nemanjës hyri në kuadrin e Rashës — shiko *Istoriya srpskog naroda, I*, f. 258; *Istoriya naroda Jugoslavije I*, f. 330. Mirëpo, duke marrë parasysh faktin se të gjitha trojet e Kosovës nuk zihen nga dokumentin e Stefan Përvoençanit, i cili mban datën e viteve 1200 dhe 1202 ka të ngjarë se Nemanja disa prej trojeve të përmendura i ka mbajtur përkohësisht. Nga burime bashkëkohore të botuara në përmbledhje të shumta (A. Solovjev, *Odabrani spomenici srpskog prava od XII do XV veka*, Beograd 1926; M. Bašić, *Stare srpske biografije*, Beograd 1926; F. Miklosich, *Monumenta Srbsca*, Vienna, 1858; S. Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjeg veka*, Beograd 1912 etj.), mësojmë se pas vdekjes së Nemanjës zhupania e Rashës mbante edhe mëtej, përveç Kosovës së atëhershme, edhe këto pjesë të Metohisë nemanjide: Patkovën, Hvosnën, Podrimjen, Kostercin dhe Dërshkovinën. Trojet e përmendura të Metohisë nemanjide ka të ngjarë se u pushtuan përkohësisht nga Nemanja dhe zhupani serb i mbajti ato deri në vitin 1190, vit kur Nemanja pësoi disfatë në betejën e Moravës. Kohë e ripushtimit të trojeve në fjalë nga ana e Nemanjidëve mund të merret periudha ndërmjet viteve 1204—1208. Nga trojet e sipërme duhet të veqenohet Prizreni dhe rrethina, që atë kohë konsiderohet si njësi e veçantë territoriale. Prizreni dhe rrethina si krahinë e veçantë hyri në kuadrin e shtetit serb pak më vonë, gjatë viteve 1207—1208, 1214—1216, apo deri në vitin 1223 — shiko R. Novaković, *O nekim pitanjima područja današnje Metohije krajem XII i početkom XIII v. ZRVI*, Beograd 1966/IX, f. 195—212; K. Jireček, *Istoriya Srba I*, f. 170.

¹² G. Ostrogorski, *Istoriya Vizantije*, f. 396—405; *Istoriya naroda Jugoslavije I*, f. 333—341, 346—361, 407—417; *Istoriya Srba I*, f. 161—236, 237—254.

¹³ G. Ostrogorski, *Istoriya Vizantije*, f. 421.

pas dispozitave të vitit 1272, i takonin Perandorisë Bizantine.¹⁴ Për të realizuar dispozitat në fjalë, në vitin 1282 bizantinët ndërmoren një ekspeditë, me anën e së cilës donin ta shtronin sunduesin dhe shtetin serb. Ushtria bizantine depërtoi deri në Lipjan dhe i dha grushta të fortë ushtrisë serbe.¹⁵ Pak më vonë, në vitin 1291, ushtria e princit të Vidinit, e ndihmuar nga hordhi tatare, pas ekspeditës së suksesshme në Braniçevë, depërtoi deri në Pejë duke lënë pas vete shkatërrime dhe dëme të mëdha materiale.¹⁶

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV, sidomos në periudhën pas vdekjes së Uroshit V, në Kosovë u shënuan ngjarje të mëdha politike. Në këtë kohë u bë edhe shkapërderdhja e Perandorisë Serbe në njësi më të vogla politiko — administrative. Këto ndryshime vërehen edhe në Kosovë. Që nga viti 1363 princ Vukashini (më vonë mbret), pjesëtar i familjes Mërnjavçeviq, filloi të zgjerohej në pjesët jugore të Perandorisë Serbe. Para betejës së Maricës (26. IX. 1371) ai ishte shtrirë edhe në një pjesë të Kosovës, si bie fjala, në Prizren. Ndërkaq, sipas M. Orbinit, në kuadrin e zotërimeve të Vukashinit, hynin Novobërda dhe „Prishtina qytet seli”. Nëse merren si të sakta të dhënat e M. Orbinit, atëherë mund të thuhet se shtrirja territoriale e Vukashinit merrte fund në rrethinën e Novobërdës dhe Prishtinës.¹⁷ Në anën tjetër, Balshajt në dhjetëvjetëshin e shtatë të shekullit XIV shfrytëzuan armiqtë e ndërmjet Mërnjavçeviqve dhe bujarëve të Rashës. Me qëllim që të realizonte aspiratat e veta, pjesëtari i familjes Balshaj, Gjergji, u martua madje me Oliverën, bijën e mbretit Vukashin. Mirëpo miqësia në fjalë nuk zgjati shumë, së shpejti ra në sprovë të vështirë. Pas betejës së Maricës, ndodh shkatërrimi i saj. Pas këtij akti Gjergji dhe vëllezërit e tij filluan të zgjeroheshin në viset e trashëgimtarit të Vukashinit. Ndër të tjera, Balshajt pushtuan edhe Prizrenin.¹⁸ Ky qytet i rëndësishëm së shpejti u sulmua nga ana e zhupanit të madh, Nikola Altomanoviq. Lidhur me sulmin në fjalë mësojmë nga ankesat e tregtarëve raguzanë që ruhen tani në serialin *Lamenta de foris* të Arkivit Historik të Dubrovnikut. Gjatë sulmit të zhupanit në fjalë, tregtarët raguzanë u strehuan në Manastirin e shënjtoreve Mihal dhe Gabriel.¹⁹ Se përnjëmend Balshajt zotëruan qytetin në fjalë për një kohë më të gjatë, bëhet fjalë edhe në një aktshkarkim të vitit 1375, sipas të cilit raguzanët në këtë vit duhej t’ua paguanin Balshajve qiranë e Doganës së Priz-

¹⁴ G. Ostrogorski, *Istorija Vizantije*, f. 428.

¹⁵ *Istorija srpskog naroda I*, f. 443; *Istorija naroda Jugoslavije I*, f. 346.

¹⁶ *Istorija srpskog naroda I*, f. 443; *Istorija naroda Jugoslavije I*, f. 350; M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, Beograd 1979, f. 98.

¹⁷ M. Orbini, *Kraljevstvo Slovena*, Beograd 1968, f. 44; R. Mihajlić, *Kraj srpskog carstva*, Beograd 1975, f. 62—63, 102—104; *Istorija srpskog naroda I*, f. 590.

¹⁸ K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka, I*, Beograd 1959, f. 379; R. Mihajlić, *Kraj srpskog carstva*, f. 66, 84, 169; Č. Mijatović, *Balšići, skica za istoriju Zeta*, Glasnik SUD Beograd 1881. XLIX, f. 196—197; G. Gelcich, *La Zedda e La dinastia dei Belsidi*, Spalato, f. 76—135.

¹⁹ AHD, *Lamenta de foris I*, f. 25; J. Dedijer *Nova Srbija*, Beograd 1913, f. 257.

renit.²⁰ Në vitin 1378 princat e Shkodrës i shtrinë zotërimet e veta edhe në Pejë.²¹ Në drejtim të Kosovës i shtrinë zotërimet e veta Kastriotët dhe Dukagjinët. Nga të dhëna raguzane dhe venedikase vërehet se trojet e Gjon Kastriotit shtriheshin prej Rodonit e deri në Prizren. Nga një marrëveshje tregtare — doganore ndërnmjet Gjonit dhe Republikës Raguzane mësojmë se kufijtë e zotërimeve të Gjon Kastriotit shtriheshin prej Shufadës, në jug të Lezhës, e deri në Prizren.²² Të dhënat për zhvillimin e komunikacionit mesjetar në Kosovë, ndër të tjera, dëshmojnë edhe për zgjerimin e familjes bujare Dukagjini në drejtim të Kosovës, përkatësisht në drejtim të Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës.²³ Pas dështimit të kryengritjes së Gjon Kastriotit, osmanët bënë regjistrimin e trojeve të tij në vitin 1432/1433. Në defterin e regjistrimit të viteve të përmendura (*Defter-i Sancak-i Arvanid*) gjendet edhe fshati Drenkurt afër Prizrenit, në trevën e Reçanit të sotëm. Si duket, edhe kjo e dhënë osmane përputhet më të dhëna raguzane se trojet e Gjon Kastriotit shtriheshin deri te Prizreni.²⁴ Lidhur me zotërimet e Dukagjinëve në Kosovë flet edhe M. Barleti: „Nikollë Dukagjini, bir i Palit, (...) ndodhet akoma gjer më sot në Peneropolis, qytet i Trakisë, të cilin sot vendasit e quajnë Prizren”.²⁵ Në shekullin XV familja Dukagjini ishte ndarë në dy degë. Njëra degë, përveç trojeve të tjera, u bë zotëruese edhe e Pejës dhe Gjakovës.²⁶ Prof. dr. I. Božičiq në një studim të vet mbi Dukagjinët e vë në pah faktin se trojet e Dukagjinave nuk janë shtrirë në Pejë, Prizren dhe Gjakovë.²⁷ Dihet nga e drejta osmane, zatën këtë e vërtetojnë disa dhjetëra fakte të nxjerra nga historia e Ballkanit dhe më gjerë, se osmanët, me rastin e regjistrimeve dhe vendosjes së administratës së vet, nuk i ndërrojnë fare emrat e toponimeve të gjetura. Meqë kjo gjë është praktikuar në tërë Perandorinë Osmane, atëherë

²⁰ M. Pucić, *Spomenici srpski II*, Beograd 1862, f. 27; Č. Mijatović, *Balsići, skica za istoriju Zeta*, f. 196; G. Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balsidi*, f. 76—135.

²¹ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI, dhe XVII*, Prishtinë 1982, f. 22; B. Djurdjev, *Uloga srpske crkve u staroj istoriji srpskog naroda*, Sarajevo 1964, f. 83.

²² S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 24; J. Radonić, *Djuradž Kastriot Skenderbeg i Arbarija u XV veku*, *Spomcnik SAN XCV*, Beograd 1942, nr. 2; K. Jireček, *Istoriya Srba I*, f. 349.

²³ K. Jireček, *Trgovački putevi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem vijeku*, botuar në *Zbornik K. Jirečeka I*, f. 280; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 30.

²⁴ H. Inalcik, *Hicri 835 Tarhili Sureti Defteri Sancak-i Arvanid*, TTKB, Ankara 1954, f. 48, nr. 51 a — 116; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 30.

²⁵ M. Barleti, *Skënderbeu, historia e jetës dhe e vepres*, Prishtinë 1967, f. 119; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 31.

²⁶ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 31

²⁷ I. Božičiq, *Nemirno Pomorje XV veka*, Beograd 1979, f. 345; Krahaso, I. Božičiq, *O Dukadžinima*, *Zbornik FF*, Beograd 1964/VIII 2, f. 395; S. Novatović, *Srbi i Turci u XIV i XV veku*, Beograd 1933, f. 252, 244—245, G. Elezović, *Turski spomenici*, I—1, *Zbornik za istorisku i književnu gradju*, Beograd 1940, f. 770—792.

shtrohet pyetja se pse të veçohet nga kjo ligjësi njësia administrative osmane e Dukagjinit.

Pjesa më e madhe e Kosovës pas vdekjes së Uroshit V i takoi Vuk Brankoviçit. Në kuadrin e zotërimeve të tij hynin Prishtina, Vuçiterna, Trepça, dhe kohë pas kohe, Peja me Prizrenin.²⁸ Pas disfatës së Nikollë Altomanoviçit në vitin 1375, zotërimeve të Vuk Brankoviçit iu shtua rajoni i Zveçanit.²⁹ Novobërda dhe rrethina, edhe pas vdekjes së Uroshit V mbetën më tutje në kuadrin e zotërimeve të Lazar Hreblanoviçit. Pasuritë e mëdha natyrore, të cilat i dispononin Novobërda dhe rrethina, i mundësuan princit në fjalë të rikthente pjesën dërmuese të viseve nemanjide dhe kështu të përtërinte shtetin serb, por jo edhe fuqinë e tij të dikurshme.³⁰

Suksesi i madh i osmanëve në Betejën e Maricës u dha mundësi atyre që të ndërmerinin ndonjë ekspeditë më serioze, meqë tani në Ballkan nuk kishte ndonjë forcë të madhe që do t'i pengonte sulmet e tyre. Në këtë situatë Kosova së shpejti u bë fushë e betejës vendimtare ndërmjet ushtrisë së krishterë të udhëhequr nga princ Lazari e cila priste në Fushë Kosovë për t'i bërë ballë ushtrisë osmane në krye me sulltan Muratin I. Burimet e shumta bashkëkohore japin të dhëna se princ Lazarin e shoqëronin Vuk Brankoviç, Gjon Kastrioti, Millosh Kopiliqi, një aradhë e Tvërtkos I, mbret i Bosnjës.³¹ Ndërkaq, shumë kronistë osman, si, bie fjala, Shukrullahu, Neshriu, Oruçi, etj, japin të dhëna se në anën e krishterë merrnin pjesë: serbë, shqiptarë, vllleh, hungarezë, çekë, bullgarë dhe venedikasë. Pjesëmarrja e popujve në fjalë në Betejën e Kosovës dëshmohet edhe sipas turkologut J. von Hammer. Në Betejën e Kosovës, përveç serbëve, barrën e luftës e bartnin edhe shqiptarët, të cilët, së bashku me serbët, përbënin pjesën kryesore

²⁸ M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, f. 148—178; F. Miklosich, *Monumenta Srbsica*, Viennae 1858, f. 173; Lj. Kovačević, *Vuk Branković, Godišnjica N. Čupića*, X, Beograd 1888, f. 229; R. Mihaljčić, *Kraj srpskog carstva*, f. 103, 121, 169—170, 203, 214—215, 219.

²⁹ Pas zhbërjes së shtetit nemanjid, duket se Trepça, si dhe Zveçani, i kanë ndërruar shpesh kryezotë. Prej vitit 1363 Zveçani është gjendur në krahinën e Vojislav Voinoviçit. Zveçani e ka sunduar edhe zhupani Nikollë Alltomanoviç, shiko, R. Mihaljčić, *Mitrovica dhe rrethina*, f. 56; R. Mihaljčić, *Kraj srpskog carstva*, f. 187—203; M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, f. 53.

³⁰ R. Mihaljčić, *Kraj srpskog carstva*, f. 86, 93, 103, 117—121, 169, 192, 195, etj.

³¹ *Istorija naroda Jugoslavije I*, f. 417—420; Për pjesëmarrjen e Balshajve në Betejën e Kosovës bëhet fjalë në dorëshkrimin e ashtuquajtur *Ad tabulam geneologicam Cassaciorum, ducum Sancto Sabba* — shiko, St. Biegl, *Spisi grofa Marsiljija (Marsiegli) u sveučilišnoj biblioteci u Bolonji (Bologna)*, GZM, Sarajevo 1910/XIII, 542 „... in campo Cossovo strenus, sed caesis christignis domum, multo, etiam suorum amisso numero, cum paucis fugiens, revertit, quo suo i adventu non multum post Hungaros quoque et Balsinos...”; Ka të ngjarë se në këtë Betejë mori pjesë edhe Gjergj Strazimir Balsha — shiko, G. Gelcich, *La Zedda e la dinnastia dei Balsidi*, Spalato 1889, 154—156; Në veprën e C. Foresti nuk gjendet emri i Strazimirit — shiko, C. Foresti, *Mappa mondo storicaa*, Venezia 1706, 159—161 „... che non nomine Giorgio II Stracimirov fra gli eroi di Kosova”.

³² J. von Hammer, *Istorija turskog carstva*, Zagreb 1979, f. 74; *Istorija naroda Jugoslavije, I*, f. 418; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve*, f. 17.

të popullsisë në Kosovën mesjetare. Filip Mezieri, e njohës i shkëlqyeshëm i Lindjes, në veprën „Song du vieil Pelerinë” thekson: „Në pjesët e Shqipërisë të krishterët arritën një fitore të madhe, Sulltan Murati, ndërkaq, dhe një bir i tij, së bashku me disa udhëheqës eminentë turk, u flijua në fushën e betejës”.³³

Edhe pse humbi jetën sovrani i ushtrisë osmane, sulitan Muratin I, turqit përmbysën pavarësinë e Serbisë, Bosnjës, Bullgarisë dhe Shqipërisë.³⁴

Pas Betejës së Kosovës territori i Kosovës, i cili kryesisht përputhet me pjesën e madhe të zotërimeve të Vuk Brankoviçit dhe të trashëgimtarëve të tij, kishte rëndësi të posaçme për turqit, me që u krijonte osmanëve mundësi që përmes luginës së Ibrit, të depërtonin në pjesët veriore të Serbisë dhe në Bosnje.³⁵ Gjatë viteve njëzet të shekullit XV osmanët orientonin gjithnjë e më tepër sulmet e veta mbi qytete, miniera, si, bie fjala, mbi Novobërdë, Trepçë, Zveçan dhe Prishtinë. Në këtë drejtim, në vitin 1427, pranë Kështjellës së Novobërdës, shihet edhe sulltan Murati II. Me këtë rast turqit pushtuan Kështjellën e Novobërdës.³⁶ Pas përtëritjes së Despotatit Serb në vitin 1444, osmanët, si edhe para rënies së tij (1439), mbanin edhe mëtutje territoret e Vuk Brankoviçit. Gjatë peripecive të shumta turqit vërtetuan edhe një herë epersinë e vet në Kosovë, duke e mundur këtu në vitin 1448 ushtrinë hungareze, të cilën e udhëhiqte Janosh Huniadi.³⁷

Derisa u bë okupimi përfundimtar nga osmanët (1455) në Kosovë bashkëjetonte dypushteti. Në Trepçë dhe Prishtinë, përveç organeve të Despotatit Serb, vepronin paralelisht edhe ato osmane. Në Trepçë zihet ngoje „sclao turcho”, i cili pengonte tregtarët raguzanë të eksportonin argjend. Ndërkaq, në Prishtinë, vepronin kadilarët dhe doganierët osmanë.³⁸ Ndikimi osman në Ballkan shtohet dita më ditë gjithnjë e më tepër, prandaj është e kuptueshme pse mbanin edhe më tutje në duart të veta pozitë që i kishin fituar në Kosovë, gjersa më në fund këto viset dhe qytetet e tyre ranë në vitin 1455 nën pushtetin e tyre.³⁹

³³ „... Et pour refraindre l'espee du dit Amorat encontre les crestiens par la bonte divine en ceste aime (sic) anee par les crestiens il a est desconfit tout a desroy et malemecheance es parties d'Albanie”. Kjo e dhënë ruhet në Bibliotekën Popullore të Parisit, fonds français N. 22, 542, fol. 366 — shiko M. Diniç, *Dva savremenika o Boju na Kosovu, GLAS, SKA, CLXXI/92, Beograd 1940*, f. 135.

³⁴ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 17.

³⁵ *Istorija naroda Jugoslavije I*, f. 420, 432—435; *Kosova dikur e sot*, f. 121.

³⁶ J. Radonić, *Zapadna Evropa i Balkanski narodi prema Turcima u prvoj polovini XV veka*, N. Sad 1905, f. 54; *Kosova dikur e sot*, f. 121.

³⁷ J. Radonić, *Zapadna Evropa i Balkanski narodi prema Turcima u prvoj polovini XV veka*, f. 253—257; *Istorija naroda Jugoslavije I*, f. 437—441.

³⁸ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 19—20.

³⁹ Burime të shumta bashkëkohore dëshmojnë se të gjitha qytetet e Kosovës ranë nën sundimin osman në vitin 1455. Sipas rezultateve të S. Rizajt, Prizreni është pushtuar nga ana e osmanëve disa herë, me 1389, 1410, 1430, 1455 dhe 1459, ndërsa Peja më 1462 shiko S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 32—33; autori i njejtë, *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva, Priština 1968*, f. 22.

2. Rrethanat ekonomiko-shoqërore në Kosovë gjatë feudalizmit të zhvilluar

Lidhur me zhvillimin ekonomik të Kosovës gjatë periudhës nemanjide dhe Despotatit ka të dhëna të shumta, meqë pasuritë natyrore të kësaj ane gjatë periudhave historike në fjalë, sidomos rajoni i Novobërdës dhe i Janjevës, punonin me kapacitete të plota. Deri vonë rezultatet historiografike në këtë lëmë mbështeteshin kryesisht në materialet burimore të ruajtura në thesarët e Arkivit Historik të Dubrovnikut dhe në Arkivin Historik të Kotorit. Ndërkaq, kohë më parë dietari kosovar, S. Rizaj, duke bërë kërkime në arkivat turq ka arritur të japë rezultate të lakmuara në këtë drejtim.

Ekspansioni serb në drejtim të jugut, që zu fill me përmasa më të mëdha në kohën e Nemanjës, mundësoi që Kosova të bëhej qendër e madhe ekonomike e Mbretërisë Nemanjide. Në kushte të reja ajo bëhet qendër e re kishtare, politike e administrative.

Në kohën e përparimit politikë të shtetit serb, popullsia e viseve të Rashës së vjetër filloi të depëronte me të madhe në drejtim të trojeve të dikurshme të Perandorisë Bizantine, pra edhe në Kosovë. Shtimi i shënuar natyror i popullsisë që shihet nga regjistrimet e pasurive kishtare të Manastirit të Deçanit, të Shënjtoreve të Graçanicës, të Shën Stefanit dhe të Banjskës, si dhe dukja e lokaliteteve të reja, tregojnë qartësisht shtimin e popullsisë kosovare, sidomos në shekullin XIV dhe në gjysmën e parë të shekullit XV.⁴⁰

Sipas kartave themeltare të manastireve të përmendura, mësojmë, ndër të tjera, hollësisht edhe për pronat e falura dhe privilegje të tjera. Rëndësia e kartave në fjalë vjen e rritet derisa dihet se nuk janë ruajtur kurrfarë të dhënash për pronat e aristokracisë laike. Si të këtilla, kartat e manastireve mund të konsiderohen gati si burime të vetme për rrethanat ekonomike në Kosovë gjatë gjysmës së parë të shekullit XIV.⁴¹

Pronat kishtare apo feudet kishtare ishin të organizuara mirë; kështu që pjesa më e madhe e ekonomisë bujqësore vilej nga pronat në fjalë. Në Kosovë, gjatë periudhës së feudalizimit të zhvilluar, nga drithërat janë kultivuar kryesisht gruri, tërshëra, meli, thekra dhe elbi. Përveç drithërave, rëndësi ka pasur edhe mbjellja e bishtajave të ndryshme. Në ekonominë fshatare në Kosovë, gjatë kësaj periudhe, kanë njohur zhvillimin pemëtaria, vreshtaria, posaçërisht, e rrethinës së Prizrenit dhe të rrethinës së Pejë, rritja e krimbit të mendafshit, bletaria dhe blegtoria.⁴²

⁴⁰ R. Mihaljčić, *Selišta*, ZFF, Beograd 1967/X—1, f. 171—224; N. Radojčić, *Zakonik cara Stefana Dušana 1349 i 1354*, Beograd 1960, f. 43—86; *Oblast Brankovića, opširni katastarski popis iz 1455 godine*, Sarajevo, 1972, f. 1—347.

⁴¹ R. Mihaljčić, *Selišta*, f. 171—224; *Kosova dikur e sot*, f. 112.

⁴² *Istorija naroda Jugoslavije*, f. 365—372; K. Jireček, *Istorija Srba I*, f. 281—285; R. Čuk, *Izvoz svile iz Dubrovnika u Veneciju u XIV veku*, IC, Beograd 1981/XXVIII, f. 17—24; *Istorija srpskog naroda I*, f. 364; B. Hrabak, *Poljoprivredna proizvodnja Kosova i susednih krajeva sredinom*

Përveç kartave të pronave të manastireve që datojnë kryesisht nga gjysma e parë e shekullit XIV, të dhëna të rëndësishme për ekonominë bujqësore të Kosovës japin edhe regjistrat osmanë, si, bie fjala, regjistrimi i vitit 1455 i krahinës së Bran'koviqëve, si dhe dokumenteve raguzane dhe kotorrane.

Krahas ekonomisë fshatare, në qytetet mesjetare të Kosovës u zhvillua edhe ekonomia qytetare, në radhë të parë zejtaria dhe tregtia. Zejtaria kosovare e periudhës mesjetare deri tani nuk ka qenë objekt i studimeve të veçanta. Trajtimet lidhur me këtë problematikë ndërkaq çonin në konstatimin se qendrat e mëdha xehetare dhe tregtare ka të ngjarë se kishin zejtarit të zhvilluara. Mosnjohja e zejtarisë qytetare duhet të arsyetohet nga mungesa e të dhënave burimore. Përjashtim lidhur me këtë konstatim bënë Novobërda. Rëndësi të veçantë për njohjen e zejtarisë së Novobërdës dhe më gjerë ka „Kodi i minierës së Novobërdës”. Kodi i posazbuluar bënë fjalë ndër të tjera edhe për çmimet e disa prodhimeve zejtare. Përveç „Kodit të minierave të Novobërdës”, si burim i dorës së parë konsiderohet edhe libri i tregtarit raguzan Mihael de Lukari.⁴³ Në Librin e M. de Lukarit gjenden të shënuar punëtorët e zejeve të shumta, si, bie fjala: farkëtarë, rrobaqepës, argjendarë, këpucëtarë, lëkurëpunues, zdrukthtarë, saraçë, kapelapunues, vorbëtarë, qiriberës, bukëpjekës, armëtarë dhe gurëskalitës.⁴⁴ Karta e Shën Stefanit dhe kartat e Manastirit të Deçanit japin një varg të dhënash për zejet mesjetare kosovare disa nga të cilat zihen ngoje edhe në Novobërdë.⁴⁵ Ndërkaq, sipas kartave të Manastirit të Prizrenit, mësojmë se në Prizren dhe rrethinë ushtroheshin këto zeje: vorbëtaria, punimi i kallajit, armëtaria, endja, saraçë, kapelapunues, leshpunues, këpucëtarë, etj. Ndërmarrja më e madhe zejtare në Prizren ishte „Shtëpia e dyllit”, të cilën e kishin ngritur kotorrasit.⁴⁶

Një kapitull të veçantë të zhvillimit të ekonomisë qytetare në Kosovë paraqiste zhvillimi i xehetarisë. Derisa për degët e lartpërmendura të ekonomisë mesjetare kosovare nuk ka të dhëna të mjaftueshme burimore, në anën tjetër, për xehetarinë, degë ekonomike me perspektivë të madhe për trevën në fjalë edhe në ditët e sotme, ka të dhëna të larmishme. Sipas S. Rizajt xehetaria kosovare ndahet në disa rajone, si, bie fjala, në xehetarinë e krahinës së Novobërdës, xehetarinë e Kopaonikut, xehetarinë e Prizrenit dhe të Dukagjinit.⁴⁷

Është për t'u theksuar se xehetaria ka dhënë impulsin themelor për zhvillimin e mëtejshëm të qyteteve kosovare. Maja edhe

XV veka, GLAS, SANU, Beograd 1974/CCXC-I, f. 33—70; V. Han, *La culture materielle dans les Balkanas au Moyen Age a travers la documentation des Archives de Dubrovnik, Balcanica*, Beograd 1972/III, f. 165.

⁴³ N. Radojčić, *Zakon o rušnicima despota Stefana Lazarevića*, SANU, Beograd 1962, f. 35—37; M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva*, I, Beograd 1957, f. 37—90.

⁴⁴ M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva* I, f. 37—90.

⁴⁵ *Istorija srpskog naroda* I, f. 268—269.

⁴⁶ S. Novaković, *Zakonski spomenici*, f. 540, nr. XIV; K. Jireček, *Istorija Srba* I, f. 286.

⁴⁷ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 115

ato qytete që nuk konsideroheshin qendra të xehetarisë, Lëheshin qendra të pavarura ekonomike, nëse gjendeshin afër minierave.⁴⁸

Monarkët serbë, duke parë se minierat kosovare u sillun pa-suri dhe zulumë të madhe, u angazhuan shumë herët për sigurimin e rezervave të reja të xeheve, kështu që në vitin 1303 zihen ngoje miniera e Trepçës dhe Janjevës. Pllana më 1346 Zapllanina më 1390, Ostraça më 1395, Bellasica më 1423.⁴⁹ Tani filloi të rritej pa masë edhe rëndësia e minierave të vjetra, që filluan të eksploatoheshin me intenzitet të shtuar. Ndërkaq, nga dhjetëvjetëshi i katërt i shekullit XV ky proces zhvillohet edhe më tepër. Lidhur me këtë zhvillim të hovshëm të xehetarisë kosovare, përveç burimeve raguzane, kotorrare dhe kishtare, ka edhe të dhëna nga bashkëkohës vendës dhe të jashtëm. Në mesin e tyre vend të posaçëm zë përshkrimi i udhëpërshkruesit francez Bortrandon de la Brokier, të Brokieri Novobërdën e gjejmë në formë Nieberge. Udhëpërshkruesi francez thotë se Novobërda gjendet në kufi midis Bullgarisë, Esklavonisë, Shqipërisë dhe Bosnjës. Në qytetin e përmendur gjendet xeherorja e përbashkët e arit dhe e argjendit. Nga kjo xeherore nxirret çdo vit ar dhe argjend me vlerë prej 200.000 dukatësh.⁵⁰

Edhe pse ndonjëherë ndaj udhëpërshkrimit të B. de la Brokierit është treguar një mosbesim, megjithatë, medievisiti i njohur jugosllav. J. Tadiq mendon se të dhënat e tija nuk kanë qenë as të stërmadhuara.⁵¹

Zhvillimi i xehetarisë dhe zejtarisë kushtëzoi që Kosova gjatë feudalizmit të zhvilluar, sidomos në shekullin e XIV dhe XV, të bëhej treg i përshtatshëm për tregtarët e viseve të ndryshme ballkanike dhe më gjerë. Transportimi i mallrave që prodhoheshin në Kosovë bëhej herë përmes rrugëve të rëndësishme mesjetare, si, bie fjala, rruga e Zetës, rrugën e Adriatikut, rruga që çonte prej Kroacisë, duke kaluar nëpër Bosnjë, për Kosovë, rruga e Raguzës për Nish, etj.⁵²

Tregjet më të njohura kosovare gjatë feudalizmit të zhvilluar konsideroheshin Prizreni, Novobërda, Prishtina, Peja, Trepça, Janjeva, etj. Meqë interesimi i raguzanëve për minierat dhe qytetet e Kosovës ishte i madh, që në shekullin XIV ata kishin kolcni në të gjitha minierat dhe qendrat ekonomike të kësaj treve. Përveç tregtarëve raguzanë, në qendrat e Kosovës vinin edhe tregtarë të Kotorrit, të Splitit etj. Tregtarë të jashtëm, ndërkaq, vinin italianë dhe grekë. Nuk ka dyshim se numri më i madh i tregtarëve ishte raguzanë. Në mënyrë që të kishin garanci për privilegjet e veta në këtë anë, tregtarët raguzanë, pas shembullit të praktikës së qyte-

⁴⁸ *Kosova dikur e sot*, f. 118.

⁴⁹ K. Jireček, *Istoriја Srba II*, f. 92—93; *Istoriја srpskog naroda*, I, f. 465.

⁵⁰ B. de la Brokier, *Putovanje preko mora*, *Naučna knjiga*, Beograd 1950, f. 132—133.

⁵¹ J. Tadić, *Privreda Dubrovnika i srpske zemlje u prvoj polovini XV veka*, Zbornik F. F. Beograd 1968/X—1, f. 534.

⁵² K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka*, f. 275—301.

teve të mëdha tregtare, si, bie fjala, Venediku, Gjenova, etj, që në vitin 1332 inauguruan institucionin konsullar në Prizren.⁵³ Fakti i sipërm tregon se sa rëndësi ka pasur ky qytet për tregtarët raguzanë. Në Kosovë filluan shumë herët të mbaheshin panairë. Mikpritës i tyre ishte vetë monarku serb. Panairët e Kosovës zënë fill që në kohën e Stefan Nemanjës, kur edhe përmendet e drejta e panairit në fshatin Hotçë afër Prizrenit. Mbreti Milutin i lejoi Manastirit të Graçanicës panair në një festë fetare. Perandori Dushan, ndërkaq, i dha po këtij manastiri tregun e Lipjanit.⁵⁴

Zhvillimi ekonomik i Kosovës gjatë shekujve XIV dhe XV bëri që të bëhej ajo qendër e madhe administrative e kishtare. Që në fillim të shekullit XIV në këtë trevë inaugurohen edhe selitë mbretërore të monarkëve të dinastisë së Nemanjidëve, si, bie fjala, Prishtina, Prizreni, Nerodimja, Pauni, Svërgçini dhe Petriqi.⁵⁵

Begatitë natyrore, pozita e mirë gjeografike dhe tradita e qemotshme e kësaj krahine ishin pa dyshim faktori vendimtar që Nemanjidët, më vonë edhe disa princa të pavarur, të zgjidhnin këtë trevë seli të vet. Për herë të parë e bëri këtë mbreti Milutin, i cili zgjodhi për seli Paunin. Më vonë, ndërkaq, selinë e vet e transferoi në Nerodimje, Prishtinë dhe Vërhllap.⁵⁶

Nerodimja ishte vend tërheqës edhe për Stefan Deçanin. Po ashtu edhe biri i tij Dushani ka qëndruar një kohë në Nerodimje, Prishtinë dhe Ribnik afër Prizrenit. Biri i perandorit Dushan, Uroshi V, si edhe i ati i tij, zgjodhi për qendër Ribnikun.⁵⁷

Pas rënies së Perandorisë serbe, në kushte të reja, sunduesit lokalë serbë, të frikësuar nga sulmet e shpeshta osmane, zgjidhnin tani për seli të veta qytete që gjenden në pjesët e Serbisë Qendrore a Veriore. Ndër kryeqytetet e vjetra nemanjide, që ishin kryesisht të vendosura në Kosovë, zihen ngoje vetëm Novobërda dhe Prishtina. Sëlia e Vuk Brankoviçit ishte në Prishtinë, ndërsa biri i tij, Gjurgaji, lëshonte shpesh dokumente nga Vuçiterna dhe rrallë nga Prishtina.⁵⁸ Despoti Stefan Lazareviç, lëshon një dokument nga Prishtina. Mirëpo, Novobërda, sipas dokumenteve bashkëkohore, shumë shpesh zihet ngoje si seli e tij.⁵⁹

Është karakteristike se serbët, duke u zgjeruar në llogari të Bizantit në fund të shekullit XIII dhe në gjysmën e parë të shekullit XIV nuk bënë ndryshime qenësore në sistemin administrativ

⁵³ K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 179.

⁵⁴ *Istorijs naroda Jugoslavije I*, f. 379—380; *Kosova dikur e sot*, f. 115.

⁵⁵ M. Orbini, *Kraljevstvo Slovena*, f. 44; K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 9, 32, 230, 351—353; *Istorijs srpskog naroda I*, f. 590.

⁵⁶ K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 8—9; *Kosova dikur e sot*, f. 111; A. Popović Vrhlab, *Belasica i župa Vrhovina, Godišnjica*, Beograd 1899/9, f. 243.

⁵⁷ K. Jireček, *Spomenici Srpski, Spomenik XI*, Beograd 1692, f. 27. K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 9; *Kosova dikur e sot*, f. 111.

⁵⁸ F. Miklosich, *Monumenta Srbcica*, f. 260, 223; K. Jireček, *Spomenici srpski*, f. 52; K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 351—353, — „in curia magnifici domini Georgii guondan Vulchi”.

⁵⁹ K. Jireček, *Spomenici srpski*, f. 40—49 (në maj të vitit 1402) dhe në f. 59 (në maj të vitit 1411); K. Jireček, *Istorijs Srba II*, f. 352.

·ekzistues Bizantin. Në qytetet e pushtuara u ruajt apo u përtëri institucioni i qefaliut. Në kushtet e krijuara në qytetet e Kosovës ky institucion zihet ngoje për herë të parë në Prizren.⁶⁰ Ndërkaq, gjatë kohës së sundimit të Dragutinit (1276—1282), në Prizren, përveç institucionit të qefaliut, përmendet edhe titulli bizantin se-vast. Përveç Prizrenit, institucioni në fjalë, më vonë, në kohën e sundimit të mbretit Milutin, (1282—1321) përmendet edhe në Hvo-sno.⁶¹

Mr. Jahja Drançolli

UN COUP D'OEIL SUR LA KOSOVÉ PENDANT LE FÉODALISME AVANCÉ

R é s u m é

Depuis l'antiquité et d'autres périodes historiques ultérieures, le territoire d'aujourd'hui de la Province Socialiste Autonome de Kosovë s'étendait au carrefour des migrations et des influences des divers pays.

Les indices de l'actualisation de la Kosovë dans l'arène internationale pendant le féodalisme avancé datent dans la deuxième moitié du IX^e siècle, relatif vers l'an 1072 ou 1073, à l'époque quant Prizren devient un centre des insurrections contre le Pouvoir bysantin.

L'avènement du Etienne Némania au pouboir serbe et la crise dans l'Empire ottoman, toutes les deux influencèrent ostensiblement à la carte politique des Balkans. Etienne Nemanja, après une longue lutte contre la Byzance envahit la plus grande partie de la Metochie du Moyen Age. Au début du XIII^e siècle, Elle passe sous le joug de l'Etat médiéval serbe, c'est ainsi que le sort de la Kosovë jusqu'en 1371 fut étroitement lié à l'Etat serbe.

Après le succès ottoman dans la bataille de Maritza (1371), passe l'autre succès, celui de la Kosovë (1389). Les succès des Ottoman dans les batailles déjà mentionnées et d'autre côté, l'anarchie qui régnait dans les territoires d'autrefois de l'Empire serbe permit aux envahisseurs qu'en l'an 1455 occupent toute la Kosovë et la Métochie médiévales.

Concernant le développement économique dans la Kosovë, pendant le féodalisme avancé, on rencontre des données de première importance dans des chartes des fondateurs des monastères, dans des defders (registres) ottomans des régions des Branković (vers 1455), dans des documents ragusiens etc. D'après les sources mentionnées dans la Kosovë, les habitants. Cultivaient des céréales, du blé, de l'avoine, du millet, du seigle et de l'orge. Pendant cette période un tel développement ont connu l'arboriculture, la viticulture, la sériculture, l'api culture, et dans certaines contrées de la Kosovë s'était bien développé l'élevage.

Parallèlement à l'économie rurale, dans les villes moyennageuse en Kosovë était bien développé l'économie urbaine, en premier lieu, l'artisanat

⁶⁰ S. Novaković, *Zakonski spomenici*, f. 683; *Istorija srpskog naroda I*, f. 538.

⁶¹ S. Novaković, *Zakonski spomenici*, f. 177, 310, 387—388, 394, 401, 407, 415, 423—424, 455—456, 471, 473, 609, 613—614, 616, 620, 644, 662, 680, 720; *Monumenta Ragusina II*, Zagrebiae 1882, f. 277.

et le commerce. Ces sources témoignent que dans les villes de Kosovë par exemple; à Prizren, à Novo Berdo et à Prishtinë pendant le féodalisme avancé sont bien exercés, à peu près tous artisanats de l'époque. Un chapitre spécial du développement de l'économie kosovarienne représente le développement des mines qui aida beaucoup au développement ultérieur des villes kosovariennes. Or, les villes qui ne se considèrent pas comme centres des mines, devinrent des centres indépendants si les mêmes se trouvèrent près de mines. Les plus grands centres des mines étaient Novo Berdo, Trepça et Janjevo. Le développement des mines et des artisanats conditionnèrent que la Région de Kosovë pendant le féodalisme avancé, surtout au XIV^e et XV^e siècle devient un centre commercial pour les commerçants des diverses régions balkaniques, c'est à dire pour les ragusiens, les Grecs, les Vénitiens etc.

